Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**28.08.2023**	**08.09.2023**	**2023/0615**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.08.2023, OE "A.R.F. SH.P.K."- Fushë Kosovë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0615, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "INFINITT SH.P.K."- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS" me nr. të prokurimit: "62500-23-6661-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 54,883.63 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 30.06.2023

Hapja e Tenderëve: 21.07.2023

Njoftimi për dhënie të kontratës: 11.08.2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0615 i dt:25.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1- Qëllimi;

Neni 6- Ekonomicitetit dhe Efikasiteti;

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminues

Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60- Kriteret për Dhunën e Kontratës;

Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Te pakenaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal Malishevë te dates **17.07.2023** ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS me numër te Prokurimit: 62500-23-6661-1-2-1. ne afatin ligjor konform nenit 109 te LPP-së, ushtrojme kete ankese prane OSHP-se:

Për shkak se AK- Kuvendi Komunal Malishevë:

- **Ne mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.**

Sqarojmë ne mënyrë te detajuar,

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Malishevë me datën 11.08.2023 ka publikuar vendimin e AK-se ku e shpërblen me kontrate një OE me te shtrenjtë sesa ne, me çmim gati dyfish me te shtrejt sesa çmimi qe kemi ofertuar nga ana jone, dhe neve na dërgon letrën standarde si tenderues i eliminuar me arsyetimin si me poshtë:

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj per pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshem:
ARSYETIM
[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye: JU ELIMINOHENI PËR ARSYJE :
- Certifikat ISO 9001 2015 E KENI ME AFAT TË SKADUAR ME DATË 25.06.2023.(JO VALIDE).

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese prane Autoritetit Kontraktues, ne bazë te nenit 108/A te Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni te shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme te prokurimit.

Me respekt,
Nuhi Shalaj

Sqaroje se AK në NJK dhe DT ka kërkuar:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1 & 7.2

Përshtatshmëria profesionale:

3.Certifikat ISO 9001 2015

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

3.Certifikat ISO 9001 2015 e noterizuar

Dhe konform nenit 59 dhe 72 AK është dashur te kërkoj sqarime e jo menjëherë et na eliminoj pasi qe neve gjat ngarkimit te tenderit tone e kemi gabuar certifikatën ne vend qe ta ngarkojmë certifikatën e re e kemi ngarkuar te vjetrën kjo gjë mund ti ndodh çdokujt dhe AK është dashur te kërkoj sqarime edhe konform nenit 10.1 te Udhëzuesit : A02_Udhezues Nr-001_2023 për prokurimin publik të KRPP-se ku ceket se:

Mungon certifikata ISO	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Ne momentin qe AK do te kishte kërkuar sqarime dhe neve menjëherë ja kishim dërguar certifikatën e re te cilën e kemi vazhduar menjëherë ne kontinuitet me certifikatën e vjetër pra sqarimet do te ishin komplet ne përputhje me nenin 72 te LPP-se ku thuhet:

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Ne rastin konkret konform pikës 1 dhe 2 te nenit 72, AK eshte dashur te na ftoj per ta qartësuar certifikatën e ngarkuar ne tenderin tone pasi qe kemi te bëjmë me nenin 69 te LPP-se qe është ne pajtueshmëri me piken 2 te nenit 72 ku thuhet për nenet 65-71, gjithashtu edhe ne pajtueshmëri me piken 1 te nenit 72 pasi qe informacionet i kemi dhënë te gabuara dhe AK është dashur te kërkoj qe ti dorëzojmë informacionet e sakta, ku dorëzimi i këtyre informacioneve është ne plotni me piken 3 te nenit 72 ku thuhet se Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet

vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve. dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pra neve e kemi certifikatën e vazhduar me validitet para datës se dorëzimit te tenderit qe shume lehtë mund te verifikohet si nga data e lëshimit ashtu edhe nga data e noterizimit te kësaj certifikate te cilën po e bashkëngjisim ne këtë kërkesë për rishqyrtim.

WQR
WORLD QUALITY REGISTRAR

CERTIFICATE
Certificate No: W-200656-Q

A.R.F. Sh.p.k.

Xhevë Lladrovci, Fushë Kosovë, Republika e Kosovës

This certificate is issued for the above-mentioned company, according to the following scope given by the WQR Certification.

ISO 9001:2015
Quality Management System

Scope of Certification
Pre-pres and pre-media services; Manufacture of paper stationery; Binding and related services; Other printing.

Release Date
28.06.2020
Last Issue Date
26.06.2023
Expiry Date
25.06.2024
Period Exp. Date
25.06.2026

Certification Manager
WQR International Certification Ltd.
www.wqrcert.com | info@wqrcert.com

ACCREDITED
CERTIFICATION BODIES
EN ISO/IEC 17021
QUALITY MANAGEMENT

The validity of the certificate can be checked through www.wqrcert.com or www.iaas.uk

REPUBLIKA E KOSOVËS
NOTER
FAIK SH. ÇOLLAKU
FUSHË KOSOVË

LRP-nr.ren.: 992 /2020

Vërtetim i kopjes së dokumentit origjinal ----------
Faik Çollaku, noter në Fushë Kosovë, rr. Nëna Terezë, nr. 141/1, vërteton me kërkesë të--
---

A.R.F SH.P.K me seli në Fushë Kosovë rruga Xhevë Lladrovci me nr. biznesi me numer unik identifikues 811255109 me pronar Z.Avdi (Halil) Koça, i lindur me njëzet e tetë maj njëmijë e nëntëqind nenëdhjetë e tre (28.05.1993) në Polac, shtetas i Republikës së Kosovës, bartës i letërnjoftimit me numër personal **1231667721**, të lëshuar nga MPB e Kosovës me datë 11.05.2018, dhe datë të skadimit 10.05.2023, me zotësi të plotë veprimi, identitetin e të cilit e konstatova në bazë të letërnjoftimit, me vendbanim në Fushë Kosovë rruga "Xhevë ----------
Ky dokument, me titull: Certificate ISO 9001:2015,me nr.-200656-Q lëshuar nga në WOR-, është fotokopje e plotë e dokumentit të përcaktuar nga pala si origjinal, të cilat më ka sjellë pala, dhe i njëjti është konform origjinalit në çdo aspekt, ka gjithsejtë një (1) fletë dhe një (1) faqe. ----------
Ky dokument është fotokopjuar në ketë zyre dhe është vërtetuar si i plotë, ndërsa **origjinali i këtij dokumenti i është kthyer palës.** ----------
---
Noteri nuk përgjigjet për përmbajtjen e këtij dokumenti.----------
---
Shpenzimet janë paguar nga pala në bazë të me nenit 27, të UATPN-së, nr. 02/2012 një euro për faqe plus 18% TVSH-ja. ----------
Veprimi i noterizimit u bë në Fushë Kosovë, në zyrën e noterit, **njëzetë e nëntë qershor maj dymijë e njëzetë(29.06.2020)ora 135:12h** ----------

Noteri:
Faik Sh. Çollaku

AK shume lehte mund ta verifikoj kete certifikate ne web faqen :

http://www.wqrcert.com/

pastaj e zgjedh gjuhen shqipe

pastaj kliko te butoni CERTIFIKATA KERKO

dhe do te hapet dritarja si me poshte:

Fute Numrin e Certifikatës .

9 + 3 = ?

Kërko

Dhe shenohet numri certifikates : W-200656-Q pastaj mbledhen numrat dhe shenohet shuma e tyre dhe shtyp butonin kerko pastaj dalin te dhenat si me poshtë:

Titulli	A.R.F. Sh.p.k.
Standardi	ISO 9001:2015 Certifikimi i sistemit për menaxhimin e cilësisë
Fushëveprimi AL	Shërbimet e përgatitjeve para-shtypjes dhe para-publikimit; Prodhimi i materialit prej letrës për zyre; Libërlidhja dhe shërbime të ngjashme; Shtypje të tjera.
EN	Pre-pres and pre-media services; Manufacture of paper stationery; Binding and related services; Other printing.
Id e Certifikatës	W-200656-Q
Data e publikimit	26.06.2020
Data e Leshimit te Fundit	26.06.2023
Data e Fillimit	25.06.2024
Data e Mbarimit	26.06.2026
Akreditimi	World Accreditation Services LLC.
Statusi i Certifikatës	Aktiv

Pra sic po shihet ne te gjitha menyrat AK e ka te lehte ta vertetojc sc certifikata eshte e leshuar para dates se dorezimit te tenderit ku edhe ne kete rast data e leshimit te fundit eshte 26.06.2023.

Pra sic shihet neve i plotesojme te gjitha kerkesat e AK-se te publikuara ne NJK dhe DT dhe kemi dhene cmimin me te lire pasi qe edhe kriter per dheni te kontrates ka qene: Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët.**

Në pergjigjen e kërkesës tone per rishqyrtim AK na ka dhene kete përgjigje si me poshtë:

Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës

DATË/A:	17.08.2023
PËR/ZA/TO:	Operatorin Ekonomik „ARF" Shpk Fushë Kosovë
CC:	OE të interesuar në këtë AP
PËRMES/PREKO/THROUGH	Z.Ekrem Kastrati - Kryetar
NGA/OD/FROM:	z.Nuhi Shalaj-Menaxher i Prokurimit - Komuna Malishevë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i kërkesës për rishqyrtim të „ARF" Shpk Fushë Kosovë që me datë 16/08/2023 ka bërë kërkesë për rishqyrtim që ka të beje me VENDIMIN e AK-së të datës 11.08.2023

Komuna e Malishevës duke vendosur sipas **KËRKESËS PËR RISHQYRTIM** të Operatorit Ekonomik **„ARF" Shpk Fushë Kosovë** të datës 16.08.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit: FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS **numer identifikues** 62500-23-6661-1-2-1 **kundër VENDIMIT** të AK të datës **11.08.2023** **mori ketë :**

V E N D I M

MBI REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË PARASHTRUAR NGA OE „ARF" Shpk Fushë Kosovë të datës 16.08.2023 **si të PA BAZUAR.**

REFUZOHET ankesa e **OE „ARF" Shpk Fushë Kosovë** e datës 16.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS **numer identifikues** 62500-23-6661-1-2-1 **kundër VENDIMIT** të AK të datës **11.08.2023.**

I. **VËRTETOHET VENDIMI i AK Komuna Malishevë** lidhur me aktivitetin e prokurimit: FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS me **numer identifikues 62500-23-6661-1-2-1.**

II. AK- Komuna Malishevë vazhdon me tutje me procedurën e prokurimit. Andaj duke u bazuar nga ato që u thane me lartë dhe LPP nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092, **AK nuk ka bëre shkelje sipas pretendimeve të OE ankues** andaj ka vendosur të refuzohet kerkesa e juaj per rishqyrtim të vendimit si e **pabazuar** si dhe mbetet në fuqi vendimi i AK i datës **11.08.2023.**

Menaxher i Prokurimit
Nuhi Shalaj

Siç po shihet AK nuk ka dhene kurrfarë arsyetimi as edhe nje fjale te vetme. Nje veprim i tile i AK-se eshte ne kundërshtim te plote me nenin **108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve** ku thuhet *"Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim."*

AK fare nuk e ka arsyetuar vendimin per refuzim.

AK qëllimisht don ta dëmtoj buxhetin e Komunes me këto vendime te kunderligjeshme.

Kërkojmë nga eksperti shqyrtues i OSHP-se dhe nga Paneli Shqyrtues qe te mos e lejojnë AK-ne te na dëmtoj kundërligjshëm neve dhe buxhetin e shtetit pasi qe kemi ofertuar me çmim gati përgjysmë me te lire se operatori i rekomanduar për kontratë dhe te na shpall fitues te këtij aktiviteti të prokurimit.

AK në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: *vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*

Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Si dhe ne piken 2 thuhet : *Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.*

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit dhe me **Çmimin më te ulët**

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga OSHP qe ta detyroj AK-ne qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi lidhur me kete lloj te aktivitetit te prokurimit dhe te nxjerr:

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional **1. OE- duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar projekte të ngjashme <u>në tri</u> vitet e shkuara nga data e njoftimit për kontratë në vlerë minimale 80,000.00 € (tetëdhjetëmijëeuro).**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **a. Një listë te kontratave të reali plotësuar, saktësuar titullin e kont e kontratës, datën e përfundimit d si dhe listës ti bashkëngjiten r <u>procesverbalet për</u> kryerje të f ngjashme,Nëse kontrata është e persona fizik, dëshmia e page bankës).**
2.<u>Mostrat duhet</u> te dorezohen me kod në zarfa (duhet te jene te shënuar me shifra kode)deri ne ora 12:00h në diten e hapjes se ofertave.	**2.<u>Mostrat duhet</u> te dorezohen me (duhet te jene te shënuar me shifra ora 12 00h në diten e hapjes se ofe**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës

DATË/A:	**17.08.2023**
PËR/ZA/TO:	Operatorin Ekonomik **„ARF" Shpk Fushë Kosovë**
CC:	OE të interesuar në këtë AP
PËRMES/PREKO/THROUGH	**Z.Ekrem Kastrati - Kryetar**
NGA/OD/FROM:	**z.Nuhi Shalaj-Menaxher i Prokurimit - Komuna Malishevë**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i kërkesës për rishqyrtim të **„ARF" Shpk Fushë Kosovë** që me datë 16/08/2023 ka bërë kërkesë për rishqyrtim që ka të beje me VENDIMIN e AK-së të datës 11.08.2023

Komuna e Malishevës duke vendosur sipas **KËRKESËS PËR RISHQYRTIM** të Operatorit Ekonomik **„ARF" Shpk Fushë Kosovë** të datës 16.08.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit: FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS **numer identifikues** 62500-23-6661-1-2-1 **kundër VENDIMIT të AK të datës 11.08.2023 mori ketë :**

V E N D I M

MBI REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË PARASHTRUAR NGA OE „ARF" Shpk Fushë Kosovë të datës 16.08.2023 **si të PA BAZUAR.**

REFUZOHET ankesa e **OE „ARF" Shpk Fushë Kosovë** e datës 16.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS **numer identifikues** 62500-23-6661-1-2-1 **kundër VENDIMIT të AK të datës 11.08.2023.**

I. **VËRTETOHET VENDIMI i AK Komuna Malishevë** lidhur me aktivitetin e prokurimit: FURNIZIM ME MATERIAL ADMINISTRATIV PËR NEVOJAT E SHERBIMEVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS SË MALISHEVËS me **numer identifikues 62500-23-6661-1-2-1.**

II. AK- Komuna Malishevë vazhdon me tutje me procedurën e prokurimit. Andaj duke u bazuar nga ato që u thane me lartë dhe LPP nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092, **AK nuk ka bëre shkelje sipas pretendimeve të OE ankues** andaj ka vendosur të refuzohet kerkesa e juaj per rishqyrtim të vendimit si e **pabazuar** si dhe mbetet në fuqi vendimi i AK i datës **11.08.2023.**

Menaxher i Prokurimit
Nuhi Shalaj

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **A.R.F. SH.P.K.**

Pretendimi 1

OE ankues pretendon se: *"AK- Kuvendi Komunal Malishevë me datën 11.08.2023 ka publikuar vendimin e AK-së ku e shpërblen me kontratë një OE më të shtrenjtë sesa ne, me çmim gati dyfish më të shtrejt sesa çmimi që kemi ofertuar nga ana jone, dhe neve na degron letrën standard si tenderues I eleminuar me arsyetimin si me poshte: Certifikata ISO 9001 2015 e keni me afat të skaduar me datë 25.06.2023. (Jovalide).*

Konform nenit 59 dhe 72 AK është dashur të kërkoj sqarime e jo menjëherë të na eleminoj pasi që neve gjatë ngarkimeve të tenderit tonë e kemi gabuar certifikatën në vend që ta ngarkojmë certifikatën e re e kemi ngarkuar të vjetrën, kjo gjë mund ti ndodhë cdokujt dhe AK është dashur të kërkoj sqarime edhe konform nenit 10.1 të Udhezuesit për PP të KRPP-së. Nëse AK kishte kërkuar sqarime menjëherë do e kishim dërguar certifatën e re"

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues pretendon se ka dorëzuar në ofertë në mënyrë të gabuar certifikatën ISO 9001-2015 me afat të skaduar. Duke u bazuar në atë se çfarë është pretenduar, sipas LPP-së, neni 59 pika i dhe ii thotë si në vijim: "Autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Po ashtu neni 72 i LPP-së, pika 1 thotë se: "Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës."

Duke u bazuar nga ajo çfarë u sqarua më lartë eksperti shqyrtues sqaron se AK është dashur që në bazë të neneve të përmendura më lartë të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues në lidhje me certifikatën e dorëzuar me afat të skaduar dhe jo të eleminoj në mënyrë direkte Operatorin Ekonomik, pa kërkuar fare sqarime. E rëndësishme është që data e lëshimit të certifikatës të jetë para datës së hapjes së tenderëve, ashtu siç e kërkon edhe Ligji për Prokurimin Publik.

Po ashtu eksperti konsideron se AK- Kuvendi Komunal Malishevë, në vendimin e kërkesës për rishqyrtim nuk i është përmbajtur nenit 108/A të LPP-së, sepse në vendimin e nxjerrur si përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim, së pari nuk e ka arsyetuar fare se përse po refuzohen pretendimet e kësaj kërkese si dhe nuk e ka përfshirë fare as pjesën e këshillës juridike në fund ashtu siç është dashur.

Andaj duke parë këtë çfarë u sqarua, më lartë, vlerësojmë se pretendimi i ngritur nga OE ankues është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa

e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **A.R.F. SH.P.K.**

Agnese Ibrahimi